

Si të përditësoni telefonin tuaj Windows



Ndiqni këto hapa për përditësimin e telefonit sipas versionit të fundit Windows


Përditësimi nëpërmjet Kompjuterit

1

Njoftimi

Kur ofrohet një përditësim, njoftimi shfaqet këtu

- ! **Këshillë:** Kontrolloni nëse njoftimet janë të aktivizuara, kaloni gishtin nga e majta në të djathtë në ekranin fillestar për në listën e Aplikacioneve dhe klikoni Settings. Pastaj klikoni **Phone update**.



2

Lidhja me USB

Duke përdorur kabllin USB të telefonit tuaj, lidhni telefonin me Kompjuterin.


- ! **Këshillë:** Kompjuteri duhet të jetë i lidhur me internetin.

3

Përditësimi Automatik

Sapo telefoni të jetë lidhur, Zune hapet automatikisht.

- Hapni programin Zune, nëse nuk fillon automatikisht Pastaj zgjidhni **Settings > Phone > Update**.
- Nëse Kompjuteri nuk e ka Zune të instaluar, do t'ju kërkojë t'a shkarkoni dhe t'a instaloni atë. Mund t'a merrni falas në www.zune.net/setup.
- Klikoni **Update Now**.



- ! **Këshillë:** Para se të filloni procesin e përditësimit, sigurohuni që Kompjuteri ka hapësirë mjaftueshëm në memorie që procesi i përditësimit të rrjedhë normalisht.
- ! **Këshillë:** Pasi përditësimi ka filluar, zakonisht ai zgjat rreth 30-60 minuta deri në përfundim. Gjatë përditësimit, nuk do të mund të kryeni apo të merrni thirrje.



Përditësimi me kompjuter Mac

Përdoruesit e kompjuterave Mac duhet të ndjekin hapat e mëposhtëm për të instaluar përditësimin. Do t'ju nevojitet aplikacioni Windows Phone 7 Connector për programin e Mac.

1

Njoftimi


Kur ofrohet një përditësim, do t'ju shfaqet një njoftim.

- ❗ **Këshillë:** Për të parë nëse njoftimet janë të aktivizuara kaloni gishtin nga e majta në të djathtë në ekranin fillestar për në listën e Aplikacioneve dhe klikoni **Settings**. Pastaj klikoni **Phone update**.

2

Lidhja me USB

Lidhni telefonin me kompjuterin Mac duke përdorur kabllin e telefonit tuaj. Aplikacioni Windows Phone 7 Connector për kompjuterat Mac duhet të hapet automatikisht. Nëse kjo nuk ndodh, në dosjen e Aplikacioneve, klikoni **Windows Phone 7 Connector for Mac**



- ❗ **Për të instaluar programin Windows Phone Connector:**
 - Hapni App Store në kompjuterin Mac
 - Kërkoni për "Windows Phone 7 Connector" dhe klikoni në rezultatin e duhur të kërkimit.
 - Klikoni butonin "Free" për të filluar procesin e instalimit (logohuni nëse nevojitet).
 - Pasi ka përfunduar instalimi, aplikacioni Windows Phone 7 Connector për programin e Mac duhet të shfaqet në ekran.

3

Përditësimi me aplikacionin Windows Phone 7 Connector për kompjuterat Mac

Në panelin e lundrimit, klikoni emrin e pajisjes dhe jo llojin e medias. Pastaj klikoni **Install Updates**.

- ❗ **Këshillë:** Nëse procesi i përditësimit nuk fillon automatikisht në aplikacionin Connector, zgjidhni **Device Options > Check For Update**.